



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Tiranë, më 22. 06. 2022

PROCESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) organizoi mbajtjen e mbledhjes së KKShC-së, ditën e Mërkurë, datë 22.06.2022, ora 15:00 në Ambjentet e Kryeministrisë Salla Ovale Kati i III-të.

Të pranishëm ishin:

Për anëtarët përfaqësues të institucioneve publike:

1. Znj. Denada Seferi– *Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*
2. Znj. Merita Xhafaj
3. Znj. Linda Pustina
4. Znj. Nina Guga
5. Z. Redinald Papa
6. Znj. Itena Çuçi
7. Z. Enio Civici
8. Znj. Olta Manjani
9. Z. Enea Hoti
10. Znj. Meri Kumbe
11. Znj. Oriana Arapi
12. Znj. Elona Ajazi

Për anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të Këshillit:

1. Z. Armando Bala
2. Znj. Fabiola Laço – Egro
3. Z. Indrit Seferi
4. Z. Vladimir Thanu
5. Z. Andi Rabiaj
6. Z. Altin Hazizaj
7. Z. Xhimi Villa
8. Z. Indrit Seferi

Përfaqësues nga AMShC:

1. Z. Andi Kananaj – *Drejtor Ekzekutiv*
2. Z. Erion Banushi
3. Znj. Paula Bero
4. Znj. Eniana Kociaj
5. Z. Ferhat Aga

Fjalën e hapjes e merr Znj. Denada Seferi Zv Ministre e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, duke falenderuar të pranishmit për pjesëmarrje më pas prezanton 5 Anëtarët e Rinj pjesë e Shoqërisë Civile në Këshill. Konkretisht: Xhimi Vila, Vladimir Thano, Mirela Juka, Altin Hazizaj, Nikolla Gjurgjaj. Më pas shprehet se vetë anëtarët e SHC-së në KKSHC kanë vendosur përzgjedhjen si Nënkyetar Z. Vladimir Thano dhe e hedh në votim. Unanimisht të gjithë ranë dakord që Nënkyetar të zgjidhet Z. Thano.

Më pas fjalën e mori Znj. Ajazi e cila realizoi një analizë në lidhje me Monitorimin e Udhërrëfyesit. Udhërrëfyesi 2019-2023 përfshin tre drejtime strategjike dhe nëntë fusha prioritare, të cilat marrin në konsideratë parimet dhe objektivat e përcaktuara në udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile.

Udhërrëfyesi dhe Plani i Veprimit parashikojnë masat/aktivitetet për çdo drejtim strategjik si dhe kostot respektive të planifikuara:

Drejtimi strategjik 1: Institucionalizimi i bashkëpunimit Qeveri-Shoqëri Civile, për bashkëpunim në hartimin e politikave dhe integrimin në BE.

5 fusha prioritare; 28 masa; 90 tregues

Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor & qeverisjes së të dhënave 2 fusha prioritare; 6 masa; 25 tregues

Drejtimi Strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm për organizatat e SHC 2 fusha prioritare; 7 masa; 30 tregues

Aktualisht janë realizuar 76% e masave dhe treguesve të planifikuara në Udhërrëfyes.

Drejtimi Strategjik i 1 përfshin 5 prioritete, 28 masa dhe 90 tregues. Në total drejtimi i parë strategjik është realizuar në masën 85%, nga të cilat:

2 Prioritete, 20 masa dhe 68 tregues janë realizuar në masën 100%

Drejtimi Strategjik i 2 përfshin 2 prioritete, 6 masa dhe 22 tregues. Në total drejtimi i dytë strategjik është realizuar në masën 64%, nga të cilat:

1 masë dhe 15 tregues janë realizuar në masën 100%

1 Prioritet është realizuar në masën 77%

1 Prioritet është realizuar në masën 51%

ARRITJET

Miratimi i Ligjit nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse"

Thjeshtësimi i procedurave formale për regjistrimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse

Fillimi punës për ngritjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar të OJF si dhe digjitalizimi i të dhënave historike të OJF (kontrata lidhur më 17.05.2022).

Prioriteti 6: Krijimi i një kuadri ligjor më mundësues për regjistrimin dhe operimin e OSHC-ve (3 masa, 14 tregues). Ky prioritet është realizuar në masën 77%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:

Ndryshimi i ligjit aktual të regjistrimit të OShC-ve për futjen e një procedure regjistrimi më të thjeshtë dhe në efçente për OShC-të dhe parashikimi me ligj i krijimit të një Regjistri Elektronik të OShC-ve – Realizuar 100%

Ndryshimi i Ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe akteve të tjera që lidhen me të (akte nënligjore dhe rregullore) për t'i dhënë mundësi QKB-së për të marrë përsipër procesin e regjistrimit të OShC-ve përmes krijimit të një Regjistri Kombëtar Elektronik të OShC-ve – Realizuar 80%

Miratimi i akteve të tjera të nevojshme ligjore dhe nënligjore lidhur me OShC-të – Realizuar 50%.

Prioriteti 7: Menaxhimi i të dhënave të OSHC-ve: mbledhja dhe analizimi i të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile në mënyrë të tillë që të kontribuojë në vendimmarrjen strategjike dhe në transparencën e skemave mbështetëse (3 masa, 11 tregues).

Ky prioritet është realizuar në masën 51%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:

Krijimi i një Regjistri Kombëtar Elektronik për OShC-të me të gjitha funksionet – Realizimi 75%.

Digjitalizimi i të dhënave dhe arkivave të OShC-ve – Realizimi 50%.

Drejtimi Strategjik 3 përfshin 2 prioritete, 7 masa dhe 30 tregues. Në total drejtimi i tretë strategjik është realizuar në masën 63%, nga të cilat:

3 masa dhe 18 tregues janë realizuar në masën 100%.

ARRITJET

Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social

Deri më sot 40 shërbime të ngritura me mbështetje financiare nga FS. Në kuadër të PBA-së 2020-2022 lidhur me mbështetjen financiare në kuadër të Fondit Social është parashikuar respektivisht: viti 2020- 70 ml ALL; viti 2021- 200 ml ALL; 2022- 200 ml ALL.

Janë shqyrtuar 45 bashki në tre vjet dhe janë financuar 33 shërbime në nivel bashkie dhe 13 shërbime në nivel qarku, me vlerë financimi në total 530 ml ALL

Publikimi Informacionit për mundësitë e financimit të programeve të OShC-ve (plane financimi dhe raporte vjetore)

Ne faqen zyrtare të AMSHC-së çdo vit publikohet Raporti Përmbledhës i cili detajon financimet, fushen e shpërndarjes së fondeve dhe aktivitetet e AMSHC se.

Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OShC-ve në aspektin e TVSh-së

OJF-te të cilat operojnë me fonde të BE-se apo projekteve të tjera, donatorët e të cilave nuk pranojnë që me këto fonde të paguhet edhe tatime në Shqipëri: (i) Eshtë miratuar nga Ministri i Financave Udhezimi për rimbursimin e OJF-ve; (ii) Janë bërë trajnime për administratën tatimore lidhur me kërkesat e OJF-ve dhe trajtimin e tyre të shpejtë; (iii) është planifikuar që në vitin 2023 të kalohet nga procedura e rimbursimit në procedurën e perjashtimit të TVSH-se që në blerje për OJF-te. U përcaktua 1 janar 2023 pasi me pare duhet të funksionojë në mënyrë të plotë sistemi i Fiskalizimit.

Prioriteti 8: Krijimi i një kuadri financiar public për mbështetjen e programeve të OSHC-ve në përputhje me praktikën e mira të BE-së (3 masa, 16 tregues).

Ky prioritet është realizuar në masën 96%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:

Rishikimi i legjislacionit ekzistues për financimin e nismave të OShC-ve nga institucionet lokale dhe qendrore të qeverisë bazuar në analizën e mangësive, duke përfshirë saktësimin e procedurave për thirrjet për propozime – Realizuar 100%

Kryerja e procedurave të marrjes së statusit të NS dhe të procedurave të financimit të ndërmarrjeve sociale nëpërmjet tre formave të mbështetjes financiare – Realizuar 83%

Kryerja e procedurave të vlerësimit të Planeve Sociale dhe të procedurave të miratimit të financimit të shërbimeve sociale nëpërmjet Programit të Fondit Social – Realizuar 100%.

Prioriteti 9: Garantimi i një trajtimi mbështetës të OSHC-ve në të gjithë vendin sa i përket raportimit të tyre financiar, kontabël dhe tatimor (4 masa, 14 tregues).

Ky prioritet është realizuar në masën 30%. Ecuria e zbatimit të masave është si më poshtë:

Heqja e detyrimit ligjor për OShC-të për të pasur një punonjës me kohë të plotë të paguar dhe të siguruar – Realizimi 0%

Harmonizimi i akteve nënligjore ekzistuese me ligjin e ri për TVSh-në të vitit 2015 për trajtimin e OShC-ve në aspektin e TVSh-së – Realizuar 100%

Hartimi i një Manuali për Kontrollin Tatimor për inspektorët tatimorë me qëllim ekskluziv trajtimin e OShC-ve në mënyrë të tillë që të marrë parasysh specifikat e sektorit dhe bërjen e trajnimeve - Realizuar 20%

Ndryshimi i Ligjit të vitit 1995 për Sponsorizimet dhe ligjet e tjera tatimore për t'u dhënë mundësi të gjithë individëve që të zbresin dhurimet që u bëjnë OShC-ve me qëllim nxitjen e filantropisë individuale – Realizuar 0%.

Më pas fjalën e mori **Znj. Arapi** e cila bëri një prezantim Rreth Partneritetit për Qeverisje të Hapur.

Ngritja e Komitetit shumëpalësh për Partneritetin për Qeverisje të Hapur bazohet në Urdhrin e Kryeministrit nr.145 datë 20.12.2021.

Bashkëdrejtues të komitetit për OGP:

- Zëvendëskryeministri

- Përfaqësues i zgjedhur nga radhët e anëtarëve të organizatave jofitimprurëse në Komitet;

Anëtarë:

Ministrin përgjegjës për Evropën dhe punët e jashtme;

Ministrin përgjegjës për punët e brendshme;

Ministrin përgjegjës për financat dhe ekonominë;

Ministrin përgjegjës për drejtësisë;

Ministrin përgjegjës për standartet dhe shërbimet;

Ministrin përgjegjës për sipërmarrjen;

Drejtorin e strukturës përgjegjëse për Mirëqeverisjen;

Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit;

Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile;

Drejtorin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje;

Përfaqësues të shoqatës më të përfaqësuar të qeverisjes vendore;

Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e demokratizimit, shtetit të së drejtës, anti-korrupsionit, të drejtave të njeriut dhe integrimi në BE;

Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e zhvillimit ekonomik;

Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e zhvillimit territorial;

Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e Zhvillimit mjedisor;

Anëtarin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësuesin e shoqërisë civile nga fusha e mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.

Mund të ftohen si pjesëmarrës në mbledhjet e hapura dhe:

Përfaqësuesi diplomatik i Ambasadës Amerikane, si i ftuar i përhershëm;

Përfaqësuesi nga USAID (dhe/ose USATA), në përputhje me tematikat e takimeve;

Përfaqësuesi nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, si i ftuar i përhershëm;

Përfaqësuesi nga komuniteti i partneritetit për zhvillim dhe integrim (DIP), në përputhje me tematikat e takimeve;

Bashkëkryetari (përfaqësues i njërive të vetëqeverisjes vendore) i Këshillit Konsultativ mes Qeverisjes Qendrore dhe Vetëqeverisjes Vendore;

Përfaqësuesi nga biznesi në Këshillin Ekonomik Kombëtar;

Kryetari i Konferencës së Rektorëve, në përputhje me tematikat e takimeve;

Kryetari i Akademisë së Shkencave, në përputhje me tematikat e takimeve;

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT;

Përfaqësues nga institucionet e pavarura, në përputhje me tematikat e takimeve.

Në këtë komitet kryen diskutime tematike për nxitjen dhe bashkërendimin e nismave konkrete në mbështetje të parimeve të hapjes, transparencës, gjithë-përfshirjes dhe promovimit të këtyre vlerave.

- Mblidhet të paktën 3 herë në vit.
- Miraton rregulloren në mbledhjen e tij të parë.
- Sekretariati teknik është struktura në nivel teknik, në Kryeministri, përgjegjëse për mirëqeverisjen dhe koordinimin ndërinstitucional të punës për iniciativën OGP.

Hapat e ardhshëm të Komitetit të OGP;

-Realizimi i takimit të parë të Komitetit Shumë-Palësh

-Përcaktimi i bashkëkryetarit nga anetërit përfaqësues të shoqërisë civile

-Miratimi i Rregullores së Komitetit Shumëpalësh dhe miratimi i paketës së metodologjisë së OGP

-Realizimi i procesit të co-creation për përgatitjen e Planit të Veprimit 2022-2024

Fjalën e mori **Z. Civici** i cili prezantoi Ligjin Nr.36/2022 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”.

Ligji nr.36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në 14 prill 2022, është botuar në Fletoren Zyrtare dhe ka hyrë në fuqi në 3 qershor 2022.

Ligji përafrohet në mënyrë të pjesshme me rregulloren e Bashkimit Evropian nr. 1303/2013 dhe nr.1305/2013 dhe është pjesë e procesit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar projektligjin, ka ndjekur procedurat e konsultimit publik, e ka propozuar në Këshillin e Ministrave, e ka prezantuar dhe mbrojtur në Kuvendin e Shqipërisë. Aktualisht po punohet me përgatitjen e akteve nënligjore për të bërë Ligjin efektiv.

Në çdo fazë të procesit, MBZHR ka treguar një kujdes të veçantë për bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, bashkëpunim që po vijon me përgatitjen e akteve nënligjore.

Ligji ka për qëllim zbatimin e qasjes së BE-së për zhvillimin rural me Pjesëmarrje, e njohur si Qasja LEADER (- Leader Approach - "Links between actions for rural development"), ku njëri prej komponentëve është krijimi dhe funksionimi i Grupeve Vendore të Veprimit (Local Group Action).

Qasja LEADER, është një nismë komunitare me traditë tashmë të konsoliduar, e konceptuar fillimisht në vitin 1991 si një laborator për të inkurajuar zhvillim rural të integruar dhe të

qëndrueshëm në BE, por pas 3 programesh të implementuara me sukses, ka arritur një nivel maturiteti dhe synohet të përdoret gjerësisht në programet kombëtare të zhvillimit rural të vet Unionit.

Grupet Vendore të Veprimit janë një instrument në një zonë LEADER me kufij të përcaktuar, që mbulon një popullsi nga 10 000 deri 150 000 banorë, për ti zhvilluar këto territore nëpërmjet funksionimit të GVV-ve, duke marr në vlerësim veçoritë dhe duke vendosur në qendër të proceseve zhvilluese interesat e një komuniteti të identifikuar nga ana gjeografike dhe e popullsisë.

Grupet Vendore të Veprimit do të jenë përgjegjës përmes partneritetit lokal dhe parimit nga lart-poshtë, përfshirjen e komuniteteve lokale në identifikimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit rural të udhëhequra nga vetë komuniteti në varësi të nevojave të tyre, marrjen e vendimeve për alokimin e burimeve financiare dhe menaxhimin e tyre bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin e një mjedisi për investimet në zonat rurale nga vetë komuniteti, ngritjen e kapaciteteve vendore, si dhe zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit përmes projekteve lokale për identifikimin dhe zbatimin e strategjive. Çdo iniciativë buron nga interesi i komunitetit lokal.

Grupet Vendore të Veprimit do të kenë fuqi vendimarrëse, do të forcojnë dialogun dhe bashkëpunimin në nivel lokal, do të prodhojnë sinergji mes aktorëve lokalë, e cila aktualisht mungon edhe për shkak të mungesës së bazës së kosnoliduar tashmë të krijuar me këtë Ligj.

Pjesë përbërëse e GVV-ve janë njerëzit, organizatat profesionale, fermerët, njësitë e vetëqeverisjes vendore, ofruesit e shërbimeve në komunitet, organizatat e grave e të rinjve dhe aktorë të tjerë lokalë. Duhet theksuar se Grupet Vendore të Veprimit mund të ndërveprojnë mes tyre për interesat e përbashkët të territoreve që përfaqësojnë, por dhe me Grupet Vendore të shteteve të tjera për realizimin e projekteve konkrete.

Identifikimi i strategjive dhe projektve do të bëhet nga vet GVV dhe po ashtu alokimi do të jetë vendimarrje e tyre. Kjo do të garantojë që financohen projekte me interes lokal e që vërtet komuniteti ka nevojë.

Ligji parashikon se funksionimi i GVV-ve mbështetet në katër parime kryesore:

1. Parimi i partneritetit.
2. Parimi territorial.
3. Parimi nga poshtë-lart.
4. Parimi i rrjetëzimit e bashkëpunimit.

Përcaktimi në Ligj i parimeve dhe detajimi i tyre, garanton përmbushjen e misionit dhe arritjen e qëllimeve nga Grupet Vendore të Veprimit. Ligji krijon parakushtet e financimit nga burime të ndryshme financimi. MBZHR dhe Qeveria Shqiptare janë drejt përfundimit të procedurave me Bashkimin Evropian të Programit “IPARD III”, dhe do të bëhet e mundur aksesi tek fondet që

Shqipëria ka siguruar nëpërmjet Programit. Mbështetja e Grupeve Vendore të Veprimit nga Programi IPARD III është konkret, do financohen rreth 10 Strategji Lokale të Zhvillimit. Buxheti i parashikuar për Masën në Programin IPARD III është 4,800,000 EUR (90% Kontributi i B.E-së dhe 10% buxheti i shtetit). Nga Programi synohen të financohen rreth 220 projekteve të tjera të vogla. Përfitimi afatgjatë lidhet me përafrimin me Politikën e Përbashkët Europiane, për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe financimin nga B.E si një nga programet e Fondit Europian për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (EAFRD).

Ligji parashikon burime të tjera financimi. Grupet Vendore të Veprimit do të aplikojnë dhe marrin financime me qëllim realizimin e projekteve të hartuara nga vet ato, për zhvillimin e zonave rurale, si, grante nga programe publike, skema garancie, partneritet publik-privat etj.

Autoritetet Publike do të përfshihen në mbështetjen e aktivitetit të GVV-ve por nuk ndikojnë në vendimarrje. Bashkëpunimi është i domosdoshëm pasi zona e veprimit është në zonat rurale dhe duhet ndërvepruar për të përmbushur qëllimet por dhe për të garantuar vijimësinë nëpërmjet financimeve.

Autoritetet publike nuk do të kenë fuqi vendimarrëse pasi komuniteti do të ketë

51 përqind të vendimarrjes gjë e cila garanton që vendimarrja të jetë tek komuniteti.

Ligji ka krijuar një ekulibër për bashkëpunimin mes Grupeve Vendore të Veprimit dhe Autoriteteve Publike, pa cënuar pavarësinë e tyre dhe pa ndikuar në vendimarrje.

Diskutime:

Në përfundim të prezantimeve Znj. Seferi ftoi për diskutime anëtarët e KKSHC-së.

Z.Thano, i rizgjedhur në mandatin e tij të dytë si anëtar i KKSHC-së, falenderoi pjesëmarrësit për prezantimet dhe idetë e reja të sjella në mbledhje si dhe për votimin unanimit të tij për postin e Zv Kryetarit të KKSHC-së, dhe vuri theksin në nevojën e zbatimit të Nenit 8 dhe 6 të Udhërrëfyesit. Z.Thano sugjeroi që brenda tre viteve të ardhshme, koordinimi mes anëtarëve të KKSHC-së dhe grupeve të vogla të punës të jetë më efikas; dhe theksoi gjithashtu nevojën e koordinimit mes grupeve të punës për kryerjen e aktiviteteve që do të ndihmojnë në përmbushjen e prioriteteve të Udhërrëfyesit.

Zv.Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Znj.Cuci pas fjalës së falenderimit, theksoi nevojën për nisma të cilat do të rrisnin shanset për vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, funksionimi i të cilave, sipas saj, nuk duhet të varet nga financime afatshkurtra por OSHC-të duhet të mbështeten për periudha afatmesme dhe afatgjata në fushat e tyre të veprimit. Znj Cuci u propozoi anëtarëve të shoqërisë civile të sjellin sugjerimet e tyre në nivel politikash apo aktiviteteve për çështje që lidhen me turizmin dhe mjedisin në Shqipëri.

Çështje të mëtejshme të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional u shtruan edhe nga Z. Altin Hazizaj, i cili propozoi konkretisht: (i) shtimin e një anëtari nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në KKSHC; (ii) adresimin e çështjeve që lidhen me fiskalizimin dhe taksat vendore për organizatat jofitimprurëse me anëtarë të Ministrisë së Financave; dhe (iii) hartimin e një liste me personat e vendosur si pika kontakti për grupet e punës në ministrinë përkatëse. Z. Hazizaj ndali gjithashtu vëmendjen edhe në mosrealizimin e disa prej prioriteteve të Udhërrëfyesit.

Pas diskutimeve, Znj. Seferi dhe Zv. Ministria e Financave, Znj. Manjani, u dakordësuan për një takim mes shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, në të cilin do të adresohen çështje të fiskalizimit dhe lehtësirave tatimore për OSHC-të.

Z. Indrit Seferi vijoi me propozime për takimet periodike sipas tematikave të grupeve të punës, dhe gjithashtu propozoi nevojën për një analizë të thelluar mbi impaktin social që aktivitetet e OSHC-ve kanë patur në shoqërinë shqiptare. Kjo analizë do t'i vinte në ndihmë jo vetëm OSHC-ve në punën e tyre, por edhe institucioneve qeveritare për të matur rëndësinë e bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri dhe për të forcuar marrëdhënien e këtyre dy të fundit.

Znj. Fabiola Egro, ndër të tjerash theksoi se shoqëria civile, sa i përket qendrueshmërisë dhe jetëgjatësisë, është momentalisht në një prej momenteve më të vështira të saj. Sipas Znj. Egro, AMSHC-ja si mekanizmi kryesor institucional për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile, është i pamjaftueshëm për të siguruar qendrueshmërinë afatgjatë të OSHC-ve.

Në mbledhjen e ardhshme të Këshillit u lanë të diskutohen propozimet e mëposhtme :

1. Propozimi i Znj. Merita Xhafaj, e cila kërkoi që AMSHC të bëjë një prezantim për shërndarjen e fondeve sipas thirrjeve dhe fushave të veprimit të OSHC-ve;
2. Propozimi i Znj. Merita Xhafaj, e cila kërkoi që OSHC-të të bëjnë prezantime në mbledhjen e KKSHC-së për realizimin e aktiviteteve të tyre;
3. Propozimi nga përfaqësues të shoqërisë civile për të diskutuar ndryshime në Ligjin 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”;